

THIRRJE PËR APLIKIME

Sipërmarrja sociale si risi në punën e organizatave të shoqërisë civile

Qëllimi i projektit është të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshmërisë së shoqërisë civile duke forcuar kapacitetet e organizatave për të përfshirë komponentin dhe vlerat e sipërmarrjes sociale në punën e tyre. Projekti është mbështetur nga Ambasada e Francës.

Programi

Trajnimet do të mbahen më **2 dhe 3 nëntor 2017**. Në trajnim do të marrin pjesë 20 përfaqësues nga organizata civile nga të gjitha qytetet e Maqedonisë. Trajnimi përbëhet nga 7 module:

- MODULI 1. Krijimi i një bote më të mirë
- MODULI 2. Krijimi i ndryshimeve sociale
- MODULI 3. Lidhjet me palët e interesuara
- MODULI 4. Spjegimi i kualitetit dhe ndikimit
- MODULI 5. Kycja e qytetarëve dhe udhëheqësia
- MODULI 6. Arritja e qëndrueshmërisë financiare
- MODULI 7. Planifikimi i sipërmarrjes sociale.

Pjesëmarrësit në trajnim do të duhet të definojnë idetë konkrete për biznes social në fushën e punës së organizatave nga të cilat vijnë dhe të njejtit të zhvillojnë biznes-plan, me fokus të veçantë në mirëmbajtjen e komponentës financiare.

Kriteriumet për zgjedhje

- Organizatat civile që punojnë në Republikën e Maqedonisë
- Organizatat që nuk egzistojnë më shumë se 10 vjet dhe kanë më pak se 10 të punësuar Përparësi do të kenë organizatat që kanë mungesë të modelit financiar për mirëmbajtjen e tyre dhe janë të varur nga financimi i projekteve të tyre nga ana e donatorëve lokal ose të jashtëm
- Projekti do ti kyqë dhe promovojë sipërmarrësit shoqëror si dhe organizatat që kanë pranuar konceptin e sipërmarrësisë sociale në punën e tyre, si shembuj pozitiv dhe bashkëpunorë që do ti propagandojnë qëllimet e projektit.
- Kandidatët e rekomanduar të mos jenë në moshën nën 23 vjeçare
- Organizata merr përgjegjësinë se kandidati të cilin e nominojnë do të merr pjesë në të gjitha aktivitetet e programit.

Si të aplikoni?

Me qëllim që të aplikoni në këtë program ju lusim që të dërgoni dokumentet në vijim:

- CV për kandidatët e nominuar nga organizata juaj (maks. 2 kandidatë nga një organizatë)
- Letër rekomandimi për kandidatët e nominuar (me nënshkrim dhe vulë)

Dokumentet për aplikim do të duhet të dërgohen më së voni deri më datë 23 Tetor 2017, në nazlije@zipinstitute.mk